




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT



Nr. Prot.

Tiranë, më 26.12.2017

Vendim
Nr. 40, datë 26.12.2017

PËR PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE MBI 100% PËR VITIN
AKADEMIK 2016-2017

Bazuar në nenin 3, pika 3, shkronjat c, d, neni 47, 49/a të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", pika 4 dhe pika 20 e udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar me udhëzimin nr. 25 datë 02.08.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, i ndryshuar" si dhe referuar shkresës me nr. 1484 Prot, datë 23.11.2017 e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, shkresës me nr. 1484/1, datë 21.11.2017 të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe relacioneve përkatëse, Bordi i Administrimit,

VËREN SE:

Nga Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë është depozituar për shqyrtim shkresa me nr. 1484 Prot, datë 23.11.2017 me anë të të cilës kërkohet të paguhet mbingarkesa mbi 100% e orëve mësimore të realizuara nga stafi akademik për vitin akademik 2016-2017. Nga ana e Administratorit arsyetohet se shkaqet e kësaj mbingarkese janë si më poshtë:

1. Mosrealizimi i procesit të rekrutimit të personelit të ri akademik në fillim të vitit akademik 2016-2017 për shkak të mosplotësimit të kriterëve nga ana e aplikantëve.
2. Gjatë vitit akademik 2016-2017 ka patur largime personeli për arsye shëndetësore.
3. Marrja e vitit sabatik e një pjese të personelit.
4. Nga analiza financiare që i është bërë raportit të rekrutimit të personelit të ri dhe përballimit të orëve shtesë nga personeli ekzistues, konkluzioni ka qenë: Marrja



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

e personelit të ri do ti rriste shpenzimet e U.V në zërin "Shpenzime për sigurime shoqërore", Artikulli 601 në masën 15%.

Në shkresë janë parashtruar në mënyrë të detajuar totali i mbingarkesës mbi 100% dhe orët përkatëse për çdo fakultet. Gjithashtu, në shkresë është parashikuar dhe vlera monetare e kësaj mbingarkese që do të përballohet nga të ardhurat e Universitetit ku parashikohet se: *"Efektet financiare të kësaj mbingarkese janë në vlerën 10.937.347 lekë. Në buxhetin e miratuar për vitin 2017 zëri "Paga dhe sigurime nga të ardhurat e institucionit" është planifikuar në vlerën 72.173.000 lekë. Deri në datën 30.09.2017 janë përdorur 23.415.426 lekë. Diferenca prej 48.757.574 lekë është përdorur pjesërisht për likuidimin e mbingarkesës prej 70% në vlerën 17.562.735 lekë".*

Relacionit të Administratorit i është bashkangjitur dhe shkresa me nr. 1448/1, datë 21.11.2017 e Drejtorisë së Financës dhe Realizimit të Buxhetit me anë të së cilës midis të tjerave parashtrohet se: *"Nga verifikimet e bëra, këto orë janë planifikuar që në marrëveshjet individuale në fillim të vitit akademik 2016-2017. Kjo pagesë është planifikuar nga të ardhurat e institucionit..."*

Gjithashtu janë bashkangjitur vendimi nr. 86, datë 04.09.2017 i Senatit Akademik *"Për miratimin e pagesës së mbingarkesës në auditor të stafit akademik të Universitetit "Ismail Qemali, Vlorë për vitin akademik 2016-2017"*, shkresën nr. 1063/5 Prot, datë 18.08.2017 të Bordit të Administrimit, shkresën me nr. 7707/1 Prot, datë 24.08.2017, protokolluar pranë U.V me nr. 1044/1 Prot, datë 28.08.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe shkresa me nr. 1283 Prot, datë 16.10.2017 nëpërmjet të cilës sqarohet se: *"Në lidhje me pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2016-2017 janë marrë në konsideratë evidencat e mësimdhënies nisur nga fakultetet. Dokumentat që janë paraqitur nga departamentet janë:*

- 1. Marrëveshja e lidhur në fillim të vitit akademik ndërmjet pedagogut dhe shefit të departamentit.*
- 2. Evidencat personale të pedagogëve.*
- 3. Evidencat përmbledhëse të Departamentit me të gjithë elementët e mësimdhënies".*

Pasi shqyrtoi gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe mori kohën e nevojshme për të zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm administrativ, Bordi i Administrimit konstaton se kërkesa e paraqitur nga ana e Administratorit është pjesërisht e bazuar.

Bordi i Administrimit vëren se ka një mbingarkesë shumë të madhe të stafit akademik. Kjo mbingarkesë është shumë e theksuar në Fakultetin e Ekonomisë, i cili ka përkatësisht 7877 orë. Arsyetimi i paraqitur nga ana e Administratorit, i cili i referohet dokumentave përkatëse se mosrealizimi i procesit të rekrutimit ka ardhur si pasojë e mosplotësimit të kriterëve nuk duhet të përbëjë justifikim për mosplotësimin e vendeve



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

vakante pranë këtij fakulteti. Rekrutimi i stafit të ri do të sillte si pasojë të drejtpërdrejtë reduktimin e orëve të mbingarkesës në këto nivele. Gjithashtu arsyesimi se rekrutimi i pedagogëve të rinj, rrit shpenzimet për sigurimet shoqërore në masën 15% është i pabazuar. Bordi i Administrimit ka miratuar numrin e përgjithshëm të stafit të U.V. Ai ka shtuar në mënyrë të konsiderueshme numrin e stafit akademik që duhet ti shpërndahet fakulteteve sipas nevojave të tyre. Rritja e numrit të stafit akademik me të vërtetë do të rriste shpenzimet për sigurime shoqërore, por gjithashtu do të rriste dhe cilësinë e mësimdhënie që ndikon drejtpërdrejtë në formimin e studentëve të Universitetit "Ismail Qemali". Nga diskutimet e bëra gjatë mbledhjeve të B.A lidhur me këtë çështje, Bordi ka ardhur në dijeni se dhe për vitin akademik 2017-2018 Universiteti ndodhet në të njëjtën situatë. Nga ana e organeve kompetente duhet të merren masat për mospërsëritjen e kësaj situate. Ligji nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*" përcakton qartë kompetencat e secilit organ në Institucionet e Arsimit të Lartë. Në këtë kontekst Bordi i Administrimit pa dashur të ndërhyjë në kompetencat e organeve kompetente, i rekomndon atyre të rishikojnë kriteret për punësimet e stafit akademik në U.V si dhe të marrin masat e nevojshme për përthithjen e një stafi të kualifikuar dhe nga universitetet e tjera të vendit, apo edhe jashtë tij.

Së dyti: Nga relatiimi që i u bë shkresave të cituara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, u konstatua se nga ana e stafit akademik janë lidhur marrëveshjet tip me përgjegjësit e departamenteve. Këto marrëveshje nuk janë miratuar/kundërfirmosur as nga Dekanët e fakulteteve dhe as nga Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë në cilësinë e titullarit të institucionit. Bordi i Administrimit është i mendimit se të gjitha marrëveshjet duhet ti kishin kaluar për miratim dekanëve dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si titullari i institucionit. Më pas nga ana e organeve kompetente duhet të merreshin masat për diskutimin e çështjes në Senat si dhe të njoftohej për këtë mbingarkesë Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në mbledhjen e datës 26.12.2017 nga ana e një pjese të anëtarëve të B.A u soll në vëmendje se Universiteti "Ismail Qemali", me anë të shkresës me nr. 1044 Prot, datë 07.08.2017 i është drejtuar MASR për të kërkuar se si do të bëhet pagesa e stafit për orët mbi normë të realizuara. Nga ana e këtyre anëtarëve argumentua se është në kompetencë të B.A që të merrte vendim në lidhje me kërkesën e paraqitur dhe jo të njoftohej MASR edhe pse një detyrim i tillë është përmbushur nga ana e U.V.

Bordi i Administrimit sqaron se me shkresën me nr. 7707/1 Prot, datë 24.08.2017, protokolluar pranë U.V me nr. 1044/1 Prot, datë 28.08.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm është sqaruar vetëm çështja e kompetencës së vendimmarrjes për rastin konkret që i përket organeve kolegjiale. Këtë kompetencë Bordi i Administrimit nuk e ka mohuar asnjëherë, madje e ka ushtruar në rastin e vendimit nr. 34, datë 20.10.2017



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

ku është miratuar pagesa deri në 100% e mbingarkesës së orëve të realizuara. Në rastin konkret, duke qenë se mbingarkesa mbi 100% është në nivele shumë të larta sidomos në Fakultetin e Ekonomisë, organet kompetente duhet të kishin njoftuar Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për ta vënë në dijeni për këtë fakt dhe si duhet të procedohej. Një veprim i tillë nuk është bërë nga ana e U.V.

Së treti: Bordi i Administrimit është i mendimit se stafi akademik i Universitetit "Ismail Qemali" nuk ka mundësi fizike për ti realizuar të gjitha këto orë, të cilat kërkohen të paguhen. Edhe nëse mundësitë fizike kanë ekzistuar, detyrimisht stafi akademik nuk ka patur mundësi të bëjë kërkim shkencor, të mari pjesë në konferenca, work-shop, apo veprimtari të tjera që ndikojnë në promovimin e tij. Ky fakt përforcohet akoma dhe më tepër në rastin e Dekanëve, zv. Dekanëve, përgjegjësve të departamenteve, drejtuesve të Qendrave të Kërkimit Shkencor etj. Kjo kategori stafi, përveç aspektit akademik, ka në kompetencë dhe çështje të menaxhimit administrativ, shkencor etj për të cilat paguhet. Nisur dhe nga eksperiencia e disa prej anëtarëve të B.A, të cilët janë pedagogë prej shumë vitesh tashmë, arrihet në përfundimin se kjo kategori e stafit akademik nuk ka mundësi të realizojë një mbingarkesë në këtë nivel. Edhe nëse me të vertetë është gjetur mundësia për ta realizuar këtë ngarkesë, atëherë detyrimisht janë lënë pas dore kompetencat e menaxhimit të fakulteteve dhe departamenteve si dhe çështjet e kërkimit shkencor, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies nga ana e studentëve. Këto faktorë ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësinë e studentëve që dalin nga auditorët e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Në këto kushte, Bordi i Administrimit është i mendimit se kjo situatë nuk duhet të përsëritet në të ardhmen. Nga ana e organeve kompetente duhet të merren menjëherë masat që të përcaktohet norma e lejuar e mbingarkesës, të vendosen kritere, të cilat do të bëjnë të mundur rekrutimin e një stafi cilësor akademik me kohë të plotë dhe jo kritere, të cilat e bëjnë të pamundur rekrutimin e tij.

Nga ana e organeve kompetente duhet që të përcaktohet vetëm një formular tip për të gjitha departamentet dhe fakultetet, të vendoset një procedurë e unifikuar në mënyrë që në të ardhmen mos të ketë situata të tilla në Univesitetin "Ismail Qemali", Vlorë. Duke qenë se deri në këto momente në U.V është e njëjta situatë përsa i përket kësaj çështjeje, rekomandohet që Senati si dhe organet e tjera kompetente ta zgjidhin këtë çështje përpara se të fillojë semestri tjetër akademik (muaji shkurt-mars 2018).

Gjithashtu nga ana e njësisë së auditimit (ose një komision i veçantë) në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë duhet të kryhet një auditim që të përcaktojë nëse të gjitha orët e pasqyruara në dokumentacion janë realizuar efektivisht, a është dërguar në Ministrinë e Arsimit ndonjë shkresë që të informojë Ministrinë për këtë situatë, a ekzistojnë kushtet fizike që këto orë të kryheshin efektivisht, a janë firmosur marrëveshjet nga dekanët dhe rektori, cila ka qenë veprimtaria shkencore dhe administrative e stafit që ka

[Handwritten signatures and initials in blue ink at the bottom of the page.]



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

mbingarkesë etj. I gjithë auditimi duhet të kryhet në frymën realizimit të një mësimdhënie cilësore në dobi të studentëve të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë duke i u referuar legjislacionit në fuqi, konkretisht ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar me udhëzimin nr. 25 datë 02.08.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 20, datë 09.05.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, i ndryshuar", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 29.03.2017 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë" të ndryshuar, vendimin nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave, pika 17 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", Kodin e Punës, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar.

Nëse nga njësia e auditimit konstatohen se orët nuk janë kryer, apo ka shkelje të tjera, të gjitha pagesat e kryera nëpërmjet këtij vendimi duhet të kthehen.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, në përfundim Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 26.12.2017,

VENDOSI:

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Të miratojë pagesën e orëve mësimore të realizuara për vitin akademik 2016-2017 mbi normën e miratuar për personelin akademik me kohë të plotë, në masën 200%
3. Në këtë pagesë përfshihet pagesa e mbingarkesës deri në 30% e likujduar nga Titullari i Institucionit si dhe pagesa e akorduar me vendimin nr. 34, datë 20.10.2017 të Bordit të Administrimit sipas propozimit të Administratorit të U.V.
4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Administratori dhe Drejtoria e Financës dhe Realizimit të Buxhetit.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Bashkangjitur këtij vendimi vendoset një kopje e shkresës nr. 1484 Prot, datë 23.11.2017 e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, shkresës me nr. 1484/1, datë 21.11.2017, shkresa me nr. 1283 Prot, datë 16.10.2017, tabelat të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit si dhe gjithë dokumentacioni relatives për këtë çështje.

1. Dr. Rezana Vrapit – Kryetar
2. Florian Nurçe – anëtar
3. Enida Pulaj – anëtar (kundër)
4. Eduard Ahmeti – anëtar
5. Elsajed Rexhaj – anëtar
6. Marinela Muço – anëtar
7. Ornella Koleka - anëtar

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.